

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2018
- Statusi Ligjor: OJQ
- Selia Qendrore: Lagjia "18 Shtatori", Apartamenti Nr.11, Pallati 6 katesh, Gjirokastër, Shqipëri
- Faqja e Internetit: mkezh.com
- Email kryesor i organizatës: shoqata.mkezh@hotmail.com, loretamamani@hotmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: 0694640798

2. Misioni

Shoqata "MKEZH" kontribuon në mbrojtjen e të drejtave, angazhimin, integrimin dhe promovimin e mekanizmave të të rinjëve, nëpërmjet ndergjegjesimit, advokimit, rritjes së kapaciteteve dhe të qenurit qytetarë aktiv në komunitetin ku jetojnë.

3. Vizioni (Opcionale)

Vizioni i jashtëm: Të rinjtë qytetarë aktiv në vendimarrje, dhe të angazhuar për advokimin e çështjeve te ndryshme qe prekin qytetin e tyre..

Vizioni i brendshëm: MKEZH një organizatë me kapacite më të rritura në mbështetje të nevojave të të rinjëve në Qarkun Gjirokastër.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

Një listë ose përshkrim i shkurtër i sektorëve ose fushave kryesore të punës së organizatës. Për shembull:

- Mbrojtja e Mjedisit
- Përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve
- Zbutja e Ndryshimeve Klimatike
- Trashëgimia kulturore dhe edukimi përmes artit
- Mbrojtja e mjedisit dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara etj.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Një përshkrim i shkurtër i projekteve, nismave ose programeve kryesore që organizata zhvillon ose ka zhvilluar:

-Ka organizuar takime sensibilizuese dhe ndërgjegjësues me temën: "Zgjidhja e konflikteve mes të rinjëve" dhe "Parandalimi i dhunës në komunitet nëpërmjet ndihmës së policimit", ne gjashtë shkolla të qytetit të Gjirokastrës. Qellimi i projektit: Te informohen dhe ndergjegjehen te rinjte mbi mekanizmet e parandalimit te dhunes permes rritjes se policimit ne komunitet.

-Qellimi i projektit: Te sjelle ne vemandje vlerat dhe trashëgimine kulturore te zones perms edicionit te pare te ketij Festivali duke promovuar trashëgimine kulturore dhe material si pjese e pasurise se madhe folklorike te zones se minoritetit grek.

-PROMOVIMI dhe TRASHEGIMIA nder breza te tradites dhe kultures se komunitetit Egjiptian, si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore jo-materiale. Target grupi janë fëmijët e komunitetit egjiptian të qytetit të Përmetit

-Qellimi i projektit: Pjesëmarrja active e t,ë rinjëve në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

6. Shtrirja Gjeografike. Rajonale dhe kombëtare. Ne deri tani kemi punuar në Qarkun e Gjirokastrës duke përfshirë qytetet: Bashkia Gjirokastër, Bashkia Përmet, Bashkia Dropull dhe tashmee jemi duke implementuar një projct në Bashkinë Libohovë.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Loreta Mamani

Bordi i Drejtuesve: përbëhet nga 7 persona

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opcionale)

- Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, dhe Bashkia e Tiranës me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian,
- financuar nga Këshili i Europës në kuadër të Programit ROMACTED 2,
- 14. Në kuadër të thirrjes për project- propozime 2022 nga Kongresi Rinir kombtar “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinise 2022”, Programi Rinia Prodhon Ekonomi Krijuese
- Ministria së Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (në process)
- Bashkimi Europian.
- Ne kuader te Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor -(ReLOaD)” i financuar nga Bashkia Permet,
- Ne kuader te skemes së granteve te projektit “ROMAKTED” me donator Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Europës,
- Mbështetur nga SCPA, dhe financuar nga ambasada Suedezë
- Komiteti Shqiptar i Helsingit

9. Ndikimi (Opcionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim në kuadër të projektit TEIST: Drejt një modeli të ri të sipërmarrjes sociale në asetet e konfiskuara në Shqipëri, zbatuar nga LIBERA – Associazioni, nomi e numeri control le mafie, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, dhe Bashkia e Tiranës me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, po implementon projektin: “Nxitja e vetëpunesimit të të rinjëve rom, përmes zanatit të thurries së shelgut, në bashkinë Gjirokastër” për periudhën 9- mujore. Qëllimi i projektit: Të trajnohen 6 te rinje rom (3 djem dhe 3 vajza) per prodhimin ne menyre artizanale te 30 produkteve te cilat me pas do te shkojne per shitje.
- Në kuadër të thirrjes për project- propozime 2022 nga Kongresi Rinir kombtar “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinise 2022”, Programi Rinia Prodhon Ekonomi Krijuese dhe Novacion, Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim, implementoi. Projektin: “Nxitja e punësimit të të rinjve përmes ngritjes së inkubatorit të artizanatit”. për një periudhë 5 mujore (1 qershor -31 tetor 2022), 1.500.000 lekë, Në këtë projekt punojnë 19 persona nga të cilët 9 meshkuj dhe 10 femra. Të angazhuar janë edhe 10 studentë nga të cilët (5 femra dhe 5 meshkuj)
- Ne kuader te Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor - (ReLOaD)” i financuar nga Bashkia Permet, Shoqata MKEZH është duke implementoi ne Bashkine Permet projektin “Bicikleta dhe rinia”. Periudha e kohëzgjatjes: Gusht 2020- Janar 2021. Fondi: 1.000.000 Leke . Qellimi i projektit: Pjesëmarrja active e të rinjëve në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Grupi i synuar ishin 30 të rinj (15 femra dhe 15 meshkuj) që do të angazhohen drejtpërdrejt në aktivitetet e projektit.
- Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim po implementon nënprojektin e akorduar në zbatim të nismës “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandës së Migrantëve në Ballkanin Perëndimor” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Projekti synon të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për një periudhë 6-mujore, me qëllim parandalimin e kontrabandimit dhe respektimin e të drejtave të tyre. Vendodhja: GjirokasterKohezgjatja: 01.08.2021 deri ne 01.02.2022. Fondi: 4.400 Euro. Objektivi i Përgjithshëm:Të kontribojmë në ofrimine shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për 150 migrantë ilegalë për një periudhë 6 mujore me qëllim parandalimin e kontrabandimit dhe respektimin e të drejtave të tyre.

10. Lajmet e Fundit/Cmimet (Opcionale)

Të gjitha aktivitetet tona janë të shfaqura në Faqet e rrjeteve sociale të Shoqatës.



Shtojca 1

Formulari i aplikimit



Ky është një aplikim individual apo organizativ për antarësimin?

Ky është një aplikim organizativ

Emri: Loreta Mbiemri: Mamani

Organizata/Institucioni: Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim

Pozicioni: Kryetar Vitet në organizatë/institucion: 7 Vite

Lloji i organizatës/Institucionit: OJQ

Drejtuesi i institucionit (emrat dhe titujt): Dr. Loreta Mamani

Detajet e kontaktit

Adresa Postare: Lagjia "18 Shtatori", Apartamenti Nr.11, Pallati 6 katesh, Gjirokastër

Kodi Postar: 6001, Qyteti: Gjirokastër Shteti: Albania

Telefon: 0694640798 E-mail: shoqata.mkezh@hotmail.com

Ëeb Faqja: mkezh.com

Fushat kryesore të ekspertizës (listo deri në 3):

- **Përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve**
- **Trashëgimia kulturore dhe edukimi përmes artit**
- **Mbrojtja e mjedisit dhe përfshirja e grupeve të margjinalizuara**

Angazhimi kryesor i advokimit:

- Për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, fëmijëve dhe grave në nevojë.
- Për fuqizimin ekonomik dhe social të shtresave të marginalizuara.
- Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.
- Për bashkëjetesë ndërkulturore dhe ndëretnike në komunitete.
- Për edukimin përmes artit, kulturës dhe vlerave qytetare.
- Për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat me trashëgimi kulturore.



Numri i stafit (nëse aplikimi është organizativ): 7 persona

Pse jeni të interesuar të bashkoheni në Rrjetin GreenAL (maksimumi 200 fjalë)?

Ne jemi të interesuar të bashkohemi në GreenAL për:

1. Thellim i ekspertizës mjedisore

GreenAL ofron mundësi për përmirësimin e kapaciteteve tona në monitorimin e ndotjes, klimës dhe biodiversitetit, gjë që lidhet drejtpërdrejt me aksionet tona në edukim mjedisor dhe sensibilizim komunitar

2. Akses në financime dhe grante

Përmes skemave të tyre të granteve tematike dhe iniciativave mund të mbështesim më mirë projektet tona lokale në zonat degradate, si dhe për të rinjtë e komuniteteve vulnerabël .

3. Rrjetëzim dhe ndikim

Duke u bërë pjesë e rrjetit, ndërtojmë lidhje me organizata mjedisore dhe aktorë institucionalë, duke forcuar bashkëpunimin, shkëmbimin e njohurive dhe ndikimin në politikat vendore e kombëtare.

Pjesëmarrja në GreenAL është një mundësi strategjike për ta forcuar punën tonë në edukimin e të rinjve dhe përfshirjen e komuniteteve vulnerabël për një mëdusë më të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Jepni konfirmimin që ky emër/organizatë të ndahet publikisht faqen GreenAL dhe të mbaheni në kontakt për aktivitete të ndryshme të Rrjetit GreenAL (Po/Jo)

_____ Po _____

Loreto Memani

MKEZH

The logo for MKEZH features two blue circles representing hands clasped together, with a stylized infinity symbol or '8' shape behind them.



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR KRIJIMIN DHE PJSËMARRJEN NË RRJETIN GREENAL



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet nga palët e interesuara (në vijim *Palët*) për krijimin dhe pjesëmarrjen në Rrjetin GreenAL (Në vijim *Rrjeti*).

Parathënie

Nga përvoja kolektive e shoqërisë civile, e fituar përmes forumeve tematike dhe kombëtare të mbajtura gjatë fazës së parë të GreenAL, u konstatua një mungesë e ndërgjegjësimit mjedisor, unititetit dhe rrjetëzimit midis aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile. Duke u bazuar në këtë përvojë, si pjesë e fazës së dytë të projektit GreenAL “Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile 2024-2027”, partnerët e tij po nxisin krijimin e një *rrjeti* të organizatave dhe aktorëve të tjerë që avokojnë për politika më të mira mjedisore dhe angazhohen në proceset vendimmarrëse mbi to në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Ky *rrjet* synon të furnizohet dhe fuqizohet përmes angazhimit dhe kontributit të anëtarëve të tij, të cilët dojen përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij. Përmes këtij bashkëpunimi, *Rrjeti* do të luajë një rol në forcimin e mëtejshëm të rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në mbrojtjen e mjedisit, promovimin e politikave të qëndrueshme dhe adresimin e sfidave mjedisore.

Neni 1 - Qëllimi dhe objektivi i bashkëpunimit

Rrjeti GreenAL synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve mjedisore, OSHC-ve të tjera jo-mjedisore, ekspertëve, aktivistëve dhe palëve të tjera të interesuara, me qëllim për të mbështetur përpjekjet kolektive për të advokuar dhe zhvilluar iniciativa të përbashkëta mbi sfidat mjedisore, si dhe për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të vizibilitetit mbi çështje mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar.

Rrjeti synon të arrijë qëllimin, nëpërmjet objektivave të mëposhtme:

- Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve mjedisore për të trajtuar në mënyrë proaktive çështjet mjedisore dhe për të përfaqësuar komunitetet e prekura;
- Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet *Palëve* nëpërmjet shkëmbimeve (takime, forume tematike, deklarata tematike, etj.), për të siguruar një qasje të unifikuar dhe të koordinuar ndaj qeverisjes mjedisore.
- Rritja e pjesëmarrjes në proceset e vazdueshme dhe të ardhshme të lidhura me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritja e përgjegjësisë së shoqërisë dhe vendimmarrësve për sfidat e ndryshimeve klimatike, mbrojtjes së natyrës dhe ndotjes në Shqipëri nëpërmjet advokimit, ndikimit në politika dhe monitorimit të dhënavëve të bazuara në prova.

Neni 2 - Organizimi

Çdo anëtar i *Rrjetit* do të caktojë një person përgjegjës për të kontribuar në aktivitetet e tij, i cili/e cila do të angazhohet në mënyrë aktive në proceset dhe iniciativat e *Rrjetit*.

Palët bien dakord për rolet dhe përgjegjësitë e mëposhtme si anëtarë në *Rrjet*:

- Të marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e *rrjetit*, duke ndarë ekspertizën e tyre dhe duke kontribuar në avokimin dhe ndikimin në proceset e hartimit të politikave mjedisore.
- Të bashkëpunojnë për një komunikim dhe koordinim efektiv ndërmjet anëtarëve të *Rrjetit*.
- Të ndihmojnë në shpërndarjen e rezultateve të *Rrjetit*, për të maksimizuar ndikimin e tij.
- Të kryejnë vlerësimë mbi progresin dhe ndikimin e iniciativave të *Rrjetit*, duke përshtatur qasjen sipas nevojës.

Neni 3 - Funksionimi dhe koordinimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në aktivitetet e mëposhtme për të arritur objektivat e *Rrjetit*:

- Dy (2) takime të *rrjetit* në vit për të diskutuar për çështjet mjedisore dhe zhvillime në këtë sektor.
- Aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e *rrjetit* për të forcuar aftësinë e tyre për adresimin e sfidave mjedisore, si p.sh. trajnime tematike.
- Angazhime për të kontribuar në proceset e politikëbërjes, si dhe angazhimi/koordinimi me aktor të tjerë lokal dhe atyre kombëtar, duke përfshirë organet qeveritare.
- Organizimi/pjesëmarrje në takime, aktivitete, forume tematike dhe asamble kombëtare për të diskutuar çështjet urgjente mjedisore dhe për të zhvilluar strategji/qasje të përbashkëta.
- Kontribut dhe shpërndarje të artikujve, dokumenteve dhe raporteve të statusit të përgjigjeve të politikave mbi Tranzisionin e Gjelbër të Shqipërisë dhe progresin mjedisor.
- Ndarje e multimedialeve (artikuj, video, etj.) që kanë në fokus çështjet mjedisore, dhe që janë në linjë me objektivat e *rrjetit*, nëpërmjet platformës digitale GreenAL për të promovuar punën e anëtarëve në territor.

Neni 4 - Konsultimi dhe informimi midis Palëve

- Personi përgjegjës do të përfaqësojë organizatën/palën e interesit në takimet e *rrjetit* dhe do të ndjekë komunikimet dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të *rrjetit*.
- Detajet e kontaktit që *palët* dorëzojnë si pjesë e shtojcës 1, do përdoren si të dhënat kryesore të kontaktit për ta.
- *Palët* nese konsiderojnë që ka zhvillime të cilat mund të janë me interes për *rrjetin* mund të informojnë pikat e kontaktit dhe të konsultohen për çështjet që konsiderohen të nevojshme për funksionimin e duhur dhe fuqizimin e qëllimit të *rrjetit*.

Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, **palët bien dakord dhe pranojnë** se komunikimi do të jetë në përputhje me pikat e mëposhtme:

- *Palët* do të plotësojnë Shtojcat e këtij Memoriandumi dhe do të bëhen pjesë e bazës së të dhënave publike të GreenAL në faqen <https://greenal.al/>
- *Palët* bien dakord të përdorin emrin dhe logot e çdo Anëtarë i Rrjetit në të gjitha komunikimet publike, deklaratat për shtyp, dhe dokumentet publike apo zyrtare, për informacionet që lidhen me dokumentet/punën e Rrjetit;
- *Palët* bien dakord që komunikimi në media në emër të Rrjetit të jetë i koordinuar dhe që anëtarët e tjerë të informohen për daljet në TV, radio, etj., dhe të diskutohen çështjet që do trajtohen dhe mesazhet kryesore që do përcillen.

Neni 5 - Kohëzgjatja, Përfundimi, Rishikimi

- Ky Memorandum Bashkëpunimi do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Përfundimi tij do të realizohet me marrëveshje midis *palëve* të përfshira.
- Mosmarrëveshjet zgjidhen gjithnjë dhe vetëm nëpërmjet mirëkuptimit midis *palëve*.
- Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshojë apo të plotësohet sipas një marrëveshje me shkrim midis *palëve*.

Neni 6 - Kushtet e etikës së Rrjetit

- Anëtarët e rrjetit të tregojnë respekt për njëri-tjetrin, duke shhangur çdo formë të sjelljes ofenduese ose diskriminuese ose të padrejtë.
- Anëtarët e rrjetit të janë transparent dhe të ndershëm në të gjitha veprimet, vendimet dhe komunikimet brenda tij.
- *Rrjeti* të sigurojë që të gjithë palët të kenë një mundësi të barabartë për të marrë pjesë, pavarësisht prejardhjes ose përkatësisë.
- *Rrjeti* të angazhohet me komunitetet lokale me respekt, duke marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e tyre.
- *Rrjeti* të angazhohet për praktika të qëndrueshme që minimizojnë dëmtimin e mjedisit.
- Anëtarët e rrjetit të janë transparent dhe të zbulojnë çdo interes personal ose organizativ që mund të ndikojë në aktivitetet e rrjetit.
- Anëtarët e rrjetit të mbrojnë informacionin e ndjeshëm që shpërndahet brenda rrjetit.
- *Rrjeti* të ruajë pavarësinë nga partitë politike, duke u fokusuar vetëm në objektivat mjedisore.
- *Rrjeti* të bazojë informacionin e ndarë në të dhëna të bazuara në fakte.
- *Rrjeti* të tregojë respekt për pronësinë intelektuale dhe të shmanget përdorimi i punës së të tjeraëve pa leje.

Neni 7 - Kopjet dhe hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga *palët* e mëposhtëm.

Nënshkrimi i *palëve të përfshira*

Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, *palët* bien dakord për detajet më sipër.

Emri i individit/organizatës dhe përfaqësuesve

Shoqata MKEZH

Data e nënshkrimit

Kryetar: Dr. Loreta MAMANI

25.06.2025

